



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C (5)**

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri : Viti III , Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Studenti duhet të ketë njohuri paraprake të nivelit A2 të gjuhës Frënge. Ai tashmë ka studiuar me sukses tre kapitujt e parë të librit A2 të metodës Alter Ego A2+. Ai është i aftë të jetë sa më shumë autonom në studimin e leksikut të ri, në aplikimin e rregullave të reja gramatikore si edhe të iniciojë vete aktivitete të komunikimit.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Plani mesimor i këtij kursi realizohet në 40 seanca seminare, në të cilat parashikohet të zhvillohen kapitujt 4, 5, 6 secila e përbërë nga tre mësimet dhe ku secila ndahet nga dy njësi didaktike. Në këto seanca seminari, parashikohen të kryhen aktivitete të aspektit gjuhësor dhe pragmatik. Studenti aftësohet në të kuptuarin me gojë (dëgjimin) dhe shprehurit me gojë sikurse në të kuptuarin me shkrim (studimi i dokumenteve të shkruar si tekste të ndryshme dhe dokumente autentike) dhe të shprehurit me shkrim ku studenti paraqet tekste të shkruar si ese të shkurtra, letra korrespondence, etj.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet :

Të marrë njohuri lidhur me leksikun në fusha dhe aspekte nga jeta e përditshme si përshebull për mediat, për aktivitete që kryhen gjatë kohës së lirë, udhëtimet

Të mund të shprehë sygjerime, të japë opinionet

Të mund të bëjë prezantime turistike të shkurtra, të bëjë rezervime, etj.

Të mund të shprehë objektivat, të justifikojë përzgjedhjet